



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit  
Opština Gnjilane  
Municipality of Gjilan  
Gilan Belediyesi

Në mbështetje të nenit 38 paragrafi 1.4, nenin 46 paragrafi 2.3 dhe nenin 82 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 16-126211 dt. 06.11.2014, me ndryshimet dhe plotësimet 01. nr. 016-28448 të dates 22.03.2018 si dhe mbështetur në pikën 3 të Vendimit 01.Nr.016-15287/26, në pikën 3 të Vendimit 01.Nr.016-15283/26, në pike 3 të vendimit 01.Nr.016-15285/26 të datës 26.02.2026 për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve në KRM "HIGJIENA", në NLP "Stacioni i Autobusëve dhe në NLP "Tregu" në Gjilan, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me 26.03.2026, miraton këtë:

**V E N D I M**  
**PËR CAKTIMIN E LARTËSISË SË KOMPENZIMIT MUJOR PËR ANËTARËT E**  
**KOMISIONIT KOMUNALE TË AKSIONARËVE NË KRM "HIGJIENA", NË NLP**  
**"STACIONI I AUTOBUSËVE" DHE NË NLP "TREGU" NË GJILAN**

1. Me këtë vendim caktohet lartësia e kompensimit mujor për anëtarët e komisionit Komunal të Aksionarëve në KRM "HIGJIENA", në NLP "Stacioni i Autobusëve" dhe në NLP "Tregua" në Gjilan.
2. Shuma e kompensimit të rregullt mujor për secilin anëtarë të Komisionit Komunal të Aksionarëve të KRM "Higjiena", të NLP "Stacioni i Autobusëve dhe të NLP "Tregu" në Gjilan caktohet në lartësi prej 350,00 € (treqind e pesëdhjet euro) bruto
3. Mjetet për kompensimin anëtarëve të Komisionit komunal të aksionarëve ndahen nga Buxheti i Komunës-Kodi buxhetor i pagave dhe mëditjeve të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik.
4. Me hyrjn në fuqi të këtij vendimi, pushon të vlejnjë Vendimet: 01.Nr.016-27888, i dt.14.03.2024 për caktimin e lartësisë së Kompensimit mujor për nëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve në KRM "Higjiena", NLP "Stacioni i Autobusëve", dhe në NLP "Tregu", në Gjilan
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari I komunës dhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës,

01.Nr.016-22113/26  
Gjilan, më 26.03.2026



Kryesuesja e Kuvendit,  
  
Krenare Latifi Kqiku/